GRUPI PUNUES PËR HARTIMIN E PROJEKT BUXHETIT TE KOMUNES SE JUNIKUT PER VITIN 2024-2026

# Dëgjimi i dytë buxhetor
# PROCESVERBAL

I mbajtur në dëgjimin e dytë buxhetor me datën 25.07.2023 në sallën e takimeve në ndërtesën e administratës komunale, duke filluar ne orën 11:05. Takimin e kryesoi Arten Hamza, Zyrtar Kryesor Financiar, Kryesues i grupit punues.

Takimin e II-të buxhetor e hapi Arten Hamza si kryesues i Grupit Punues i formuar me vendim të kryetarit të komunës z. Ruzhdi Shehu.

Ky takim- dëgjim Buxhetor është i orientuar vetëm për Gratë e Junikut të këshilluar edhe nga organizatat mbështetëse për komunën. Në këtë rast falënderim i veçante për organizatat mbështetëse si: Demos dhe z. Ibrahim Kryeziu – përfaqësues i Demos

Pasi përshëndeti dhe falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje Arten Hamza filloi me prezantimin e dëgjimit të II-të për Buxhetin, ai tha se Qarkorja e I-rë buxhetore 2024/01 është pranuar në Maj përkatësisht me 15.05.2023, më tutje theksoi se janë disa hapa dhe faza drejt hartimit të projekt buxhetit për periudhën 2024/2026 ku si dokument i parë kërkohet qe te hartohet Korniza Afatmesme Buxhetore 2024/2026 e cila duhet qe te hartohet dhe aprovohet deri me 30.06.2023 dhe te dërgohet ne Ministrinë e financave, punës dhe Transfereve, pastaj do te lëshohet Qarkorja e dyte buxhetore e cila i përcakton kategoritë shpenzuese dhe në bazë të së cilës duhet që të hartohet projekt buxheti 2024/2026 dhe të aprovohet deri me 30 shtator.

Më tutje spjegoi hapat e hartimit të KAB duke theksuar rëndësinë e mbajtjes së takimeve dhe dëgjimeve buxhetore deri te hartimi i KAB-it dhe projekt buxhetit.

Gjithashtu tha se edhe pse dihet se si komunë e vogël edhe mundësitë buxhetore janë të kufizuara, por prapë se prapë projekt propozimet merren parasysh dhe vendosen në strategji komunale.

Ai shtoi se Buxheti i përgjithshëm për 2024 sipas Qarkores se pare 2024/01 është 2,199,836.00 , nga këto si burim financimi janë:

- Granti i përgjithshëm 1,103,827.00
- Granti specifik për arsim 544,726.00

- Granti specifik për shëndetësi 343,227.00, dhe
- Të hyrat vetanake 208,056.00 .

Dhe nga kjo gjatë hartimit të buxhetit fillimisht planifikohen buxheti i shpenzimeve operative pastaj pjesa tjetër planifikohet për investime kapitale ku përafërsisht planifikohet diku rreth 350,000.00 - 400,000.00 € për kategorinë e investime kapitale për vitin 2024.

Më tutje tha se ky grup punues i formuar sipas kërkesave ligjore për hartimin e buxhetit me vendim të kryetarit të komunës z. Ruzhdi Shehu, do të jetë përgjegjës për procedurat e planifikimit të buxhetit, dhe të gjitha propozimet do të pranohen dhe adresohen në drejtori përkatëse për tu vendosur nëpër strategji. Pastaj projektet e propozuara nga pjesëmarrësit do të financohen dhe renditen sipas përparësisë dhe rëndësisë.

Po ashtu gjatë diskutimit tha se propozimet nga dëgjimi i parë buxhetor janë pranuar dhe listuar, Dhe krahas kësaj planifikohen edhe tre dëgjime buxhetore si :

- 15.08.2023 ----- Grupi Punues
- 15.09.2023 ------KPF,

Mirëpo në rast se ka iniciativa dhe kërkesa për mbajtje edhe të takimeve tjera shtesë gjithsesi do i fusim në agjendën e planifikimit dhe mbajtjes së rregullt.
Ai ri theksoi se të gjitha projekt propozimet pranohen nga anëtarët e GP, listohen dhe adresohen tutje.
Gjithashtu të gjitha informatat lidhur me planifikim buxheti janë publike dhe mund ti gjeni në web faqen e komunës së Junikut.
Me kaq e mbylli prezantimin e tij kryesuesi i Grupit Punues z, Arten Hamza i cili më pastaj fjalën ua e kaloi tek pjesëmarrëset për propozime.

Nga të pranishmit fjalën e mori znj. Rajmonda Kraniqi – anëtare e kuvendit të komunës së Junikut e cila kërkoi:

- përmirësimi i shërbimeve shëndetësore në Junik për gratë e prekura nga kanceri- të ofrohet shërbim i mamografisë së paku një herë në vit.

- Të ofrohen shërbime gjinekologjike pranë QKMF-së në Junik sipas ndonjë orari ose programi të mundshëm.

Znj. Florinda Kukalaj kërkoi:

- Organizimi dhe mbajtja e ndonjë kursi profesional për pastiqeri,
- Organizimi dhe mbajtja e ndonjë kursi profesional për rrobaqepësi, floktari etj.
- Funksionalizimi i çerdhes së fëmijëve me orar të plotë.

Arten Hamza kërkoi që GP ti ofrohet një projekt propozim për një organizimin e një kursi, dhe të përfshihet vlera e përafërt financiare sepse mund ta organizojmë me bashkëfinancim.

Z. Ibrahim Kryeziu mbështetës nga Demos tha : Të kontaktohet qendra për punë sociale për të marr certifikata për kursin e kryer.

Të përpilohet lista dhe të kërkohet bashkëpunimi edhe prej zyrës së punësimit dhe socialit.

Pastaj Mori fjalën Arten Hamza i cili tha se dëgjimi buxhetor nuk përfundon sot. Idetë dhe projekt propozimet tuaja mund të pranohen dhe adresohen në email, web faqe të komunës ose propozim në kopje fizike te znj. Vjollca Qestaj deri me datë 01.09.2023.

Projekt propozimet pranohen si do që juve ju vjen më lehtë.

Znj. Saranda Isufaj propozoi ndërtimin e shtëpisë së pleqve.

Pas këtyre propozimeve nuk pati ndonjë pjesëmarrës tjetër i cili dëshironte qe te merrte fjalën dhe pastaj mori fjalën Arten Hamza dhe tha se Grupi Punues do ndjek procedurat, hartojë procesverbalin dhe raporti do i prezentohet ekzekutivit dhe kuvendit.

Gjithashtu shprehu shqetësimet e tij sepse pjesmarrja në dëgjim buxhetor është e vogël dhe iu drejtua me kërkesë pjesëmarrësve që të ngrisin si çështje dhe sa më shumë të sensibilizojnë qytetarët për pjesëmarrje. Gjithashtu tha se do të mbahen edhe takime tjera të grupeve të ineteresit.

Pastaj z. Arten Hamza mori fjalën përmbyllëse pasi nuk pati propozime tjera duke falënderuar të pranishmet, për pjesëmarrje dhe sensibilizimin e gruas që të jenë më aktive.

Për fund tha: inkurajoheni të merrni pjesë në dëgjime publike me qëllim të propozimit dhe realizimit të projekteve të cilat ndikojnë në përmirësimin e kualitetit të jetës së qytetarëve.

Faleminderit për pjesëmarrje dhe mirë u takofshim në dëgjimet e radhës.

Në këtë dëgjim publik ishin gjithsejtë 13 pjesëmarrës ku 11 nga totali i pjesëmarrësve ishin te gjinisë femërore.

Procesmbajtëse:

I.d.a Ferdone Tofaj

Të përpilohet lista dhe të kërkohet bashkëpunimi edhe prej zyrës së punësimit dhe socialit.

Pastaj Mori fjalën Arten Hamza i cili tha se dëgjimi buxhetor nuk përfundon sot. Idetë dhe projekt propozimet tuaja mund të pranohen dhe adresohen në email, web faqe të komunës ose propozim në kopje fizike te znj. Vjollca Qestaj deri me datë 01.09.2023.

Projekt propozimet pranohen si do që juve ju vjen më lehtë.

Znj. Saranda Isufaj propozoi ndërtimin e shtëpisë së pleqve.

Pas këtyre propozimeve nuk pati ndonjë pjesëmarrës tjetër i cili dëshironte qe te merrte fjalën dhe pastaj mori fjalën Arten Hamza dhe tha se Grupi Punues do ndjek procedurat, hartojë procesverbalin dhe raporti do i prezentohet ekzekutivit dhe kuvendit.

Gjithashtu shprehu shqetësimet e tij sepse pjesmarrja në dëgjim buxhetor është e vogël dhe iu drejtua me kërkesë pjesëmarrësve që të ngrisin si çështje dhe sa më shumë të sensibilizojnë qytetarët për pjesëmarrje. Gjithashtu tha se do të mbahen edhe takime tjera të grupeve të ineteresit.

Pastaj z. Arten Hamza mori fjalën përmbyllëse pasi nuk pati propozime tjera duke falënderuar të pranishmet, për pjesëmarrje dhe sensibilizimin e gruas që të jenë më aktive.

Për fund tha: inkurajoheni të merrni pjesë në dëgjime publike me qëllim të propozimit dhe realizimit të projekteve të cilat ndikojnë në përmirësimin e kualitetit të jetës së qytetarëve.

Faleminderit për pjesëmarrje dhe mirë u takofshim në dëgjimet e radhës.

Në këtë dëgjim publik ishin gjithsejtë 13 pjesëmarrës ku 11 nga totali i pjesëmarrësve ishin te gjinisë femërore.

Procesmbajtëse:

I.d.a Ferdone Tofaj

REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
JUNIK

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK– MUNICIPALITY OF JUNIK

**Drejtoria për Buxhet dhe Financa**

**Datë: 25.07.2023**

## DËGJIMI PUBLIK PËR BUXHETIN 2024-2026 ME GRATË E KOMUNËS SË JUNIKUT

| Numri | Emri dhe Mbiemri | Komuna | Nr. i telefonit | Email-i | Nënshkrimi |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Flurije Shehu Kryeziu | Junik | 044329486 | flurije-sh64@hotmail.com | [signature] |
| 2 | Gentiana Tafaj | Junik | 046-106-306 | gentiana.tafaj@rks-gov.net | [signature] |
| 3 | Leonora Shehu | Junik | 046-106-300 | leonora.u.sheh@rks-gov.net | [signature] |
| 4 | Xhevahire Krasniqi | Junik | 049-760-256 | Xhevahire.krasniqi@rks-gov.net | [signature] |
| 5 | Saranda Isufaj | Junik | 045-379-004 | saranda.isufaj@rks-gov.net | [signature] |
| 6 | Florinda Kukalaj | Junik | 045/312/963 | florindamaloku@rks-gov.net | [signature] |
| 7 | Festina Maloku | Junik | 049-787-766 | festinamaloku15@gmail.com | [signature] |
| 8 | Esmelinda Llolluni | Junik | 045-648-611 | esmelindallolluni@gmail.com | E. Llolluni |
| 9 | Rajmonda Krasniqi | Junik | 044-880-447 | rajmonda.krasniqi@rks-gov.net | [signature] |
| 10 | Vjolca Gestaj | Junik | 046-106-286 | vjolca.gestaj@-rks-gov.net | [signature] |
| 11 | Fardonje Tofaj | Junik | 044798580 | fardon.tofaj@rks-gov.net | [signature] |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 12 | IBRAHIM KRYEZIU | DEMOS | +38344185336 | ibrahimkryeziu2002@yahoo.com | |
| 13 | ARTEN HAMZA | JUNIK | 044264079 | arten_hamza@rks-gov.net | |
| 14 | | | | | |
| 15 | | | | | |
| 16 | | | | | |
| 17 | | | | | |
| 18 | | | | | |
| 19 | | | | | |
| 20 | | | | | |
| 21 | | | | | |
| 22 | | | | | |
| 23 | | | | | |
| 24 | | | | | |
| 25 | | | | | |
| 26 | | | | | |
| 27 | | | | | |
| 28 | | | | | |
| 29 | | | | | |
| 30 | | | | | |
| 31 | | | | | |
| 32 | | | | | |
| 33 | | | | | |
| 34 | | | | | |
| 35 | | | | | |
| 36 | | | | | |
| 37 | | | | | |